

## **RREGULLORE PËR IMPLEMENTIMIN E**

### **KA107 – INTERNATIONAL CREDIT MOBILITY – MOBILITETI NDËRKOMBËTAR I KREDITEVE**

#### **TË PROGRAMIT ERASMUS+**

##### Neni 1

Universiteti i Arteve është nënshkruar i Marrëveshjeve Ndërinstitucionale në cilësinë e një Institucioni të Arsimit të Lartë të Vendeve Partnere (Partner Countries) me Vendet e Programit (Programme Countries) përcaktuar sipas Udhërrëfyesit të Programit Erasmus + ([http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/node\\_en](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/node_en)).

##### Neni 2

Marrëveshjet Ndërinstitucionale (Inter – Institutional Agreement) formulohen dhe nënshkruhen sipas formatit të Programit Erasmus nga përfaqësuesit ligjorë të institucioneve të përshkuara në marrëveshjen ndërinstitucionale, pasi paraprakisht të jenë ndërmarrë hapa konkretë për përcaktimin e përmbajtjes së Marrëveshjes, përmes një Memorandumi Mirëkuptimi midis institucioneve që synojnë të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Ndërinstitucionale.

##### Neni 3

Studentët Bachelor apo Master që synojnë të realizojnë një mobilitet pranë një institucioni të Vendeve të Programit të përfshirë në Marrëveshjen Ndërinstitucionale duhet të informohen zyrtarisht për Hapjen e Thirrjes për kandidaturat e mobiliteteve Erasmus+. Prioritet kanë studentët që kanë një mesatare rezultatesh të provimeve të realizuara nga 9,5 e lart.

Në rastet kur, nga disiplinat e përcaktuara në Marrëveshjen Ndërinstitucionale, studentët kandidatë nuk e përmbushin këtë kusht, komisioni i vlerësimeve të kandidatave ka mundësinë të konsiderojë edhe kuota më të ulët se 9,5.

##### Neni 4

Hapja e Thirrjes për kandidaturat e mobiliteteve Erasmus+ realizohet përmes publikimit të saj në ëebsite-in e Universitetit të Arteve. Komisioni i vlerësimeve të kandidatave ngrihet me propozim të Koordinatorit të Programit Erasmus+ për Universitetin e Arteve dhe merr në shqyrtim dokumentacionin e kandidatëve. (Lista e Notave, Dëshmia e gjuhës së huaj – minimum niveli B2, Formulari i Aplikimit, Marrëveshja sipas formatit standart "Learning Agreement", Letër Motivimi, Letër Rekomandimi, CV format European)

##### Neni 5

Studentët që do të përfitojnë nga Mobilitetet e Programit Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë regjistrimi ose shkollimi pranë institucioneve pritëse. Studentët përfitues duhet të vazhdojnë të paguajnë shkollimin dhe/ose tarifën e regjistrimit pranë institucionit dërgues të origjinës.

Në rastin kur, studenti përfitues ndjek semestrin e parë pranë një institucioni pritës, përveç Learning Agreement, do të nënshkruajë dhe një Marrëveshje shtesë me institucionin dërgues, ku, përfituesi angazhohet të mos ndërpresë marrëdhëniet e shkollimit me institucionin dërgues për vitin akademik në vazhdim dhe është i detyruar që të pagojë kuotën vjetore të shkollimit pranë institucionit dërgues.

Mosnënshkrimi i kësaj marrëveshjeje do të nënkuptojë penalitetin automatik të heqjes së bursës së mobilitetit.

Studentët Bachelor apo Master që realizojnë një mobilitet pranë një institucioni të Vendeve të Programit të përfshirë në Marrëveshjen Ndërinstitucionale kanë të drejtë të transferojnë Vlerësimet e fituara dhe Kreditet e njohura të Disiplinave Universitare të ndjekura pranë institucionit të arsimit të lartë pritës, sipas kushteve të parashikuara në "Learning Agreement".

#### Neni 6

Sistemi i vlerësimit të studentëve përfitues parashikohet në Marrëveshjen Ndërinstitucionale (Inter - Institutional Agreement) pika G, (Grading systems of the institutions) dhe respektohet si nga Komisionet e ngritura posaçërisht në çdo dekanat ashtu edhe nga Sekretaria Mësimore.

#### Neni 7

Lëndët që nuk ndiqen përgjatë bursës së mobilitetit në institucionin pritës, do të zhvillohen pranë institucionit dërgues. Studenti përfitues ka të drejtë të mbartë provime në vitin pasardhës sipas rregullave në fuqi të sistemit universitar dhe të specifikave të rregulloreve të vetë institucionit dërgues.

#### Neni 8

Sekretaria mësimore nxjerr, pasi verifikimit të dokumentacionit të studentit përfitues, detyrimet e mbetura për mbylljen e vitit akademik të dhënë dhe i përditëson ato në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve ESSE3.